



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

NJOFTIM

Në mbledhjen e datës 10 gusht 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve të zhvilluara dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, mori vendimet që vijojnë:

U miratuan procesverbalet e mbledhjeve të Bordit të ERE-s, përkatësisht nr. 30, datë 06.07.2026; nr. 31, datë 13.07.2026; nr. 32, datë 21.07.2026; nr. 33, datë 24.07.2026 dhe nr. 34, datë 28.07.2026.

U përcaktua çmimi i shitjes së energjisë elektrike muajin korrik 2026, për klientët e furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF), të lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, në vlerën 15.12 lekë/kWh.

U miratua kërkesa e shoqërisë “GLOBAL INTERPRISE GROUP” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Doma”, me kapacitet të instaluar **1.695 MW**, me vendndodhje në përroin e Lusës, degë e Lumit Mat, Bashkia Klos, Qarku Dibër ,për një afat 30-vjeçar. Shoqëria duhet të nisë operimin e HEC-it brenda datës 23 janar 2027.

U vendos fillimi i procedurës administrative për shqyrtimin e kërkeses së shoqërisë “3X ENERGY” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 70 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale 3268, fshati Savër, Njësia Administrative Lushnjë, Bashkia Lushnjë, Qarku Fier.

Projekti parashikon gjithashtu sisteme të akumulimit të energjisë, për të cilat ERE po vijon vlerësimin në përputhje me kuadrin ligjor dhe kontraktual në fuqi.

U miratua fillimi i procedurës administrative për licencimin e shoqërisë **për licencimin e shoqërisë “KRONOS KONSTRUKSION” shpk, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike impianti fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 50 MW, me vendndodhje në afërsi të Fshatit Vërnik, Njësia Administrative Qendër Bilisht, Bashkia Devoll, Qarku Korçë.**

U miratua llicencimi i shoqërisë “GERTI” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 10 MW, me vendndodhje në Vlashaj, Njësia Administrative Shupenzë, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër. **Shoqëria duhet të fillojë operimin/ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 31.07.2027.**

U miratua transferimi i plotë i licencës së prodhimit të energjisë elektrike, të dhënë shoqërisë “DRINI BULQIZË” sh.p.k. me vendimin nr. 77, datë 29.04.2024, për HEC “Polemi”, me kapacitet të instaluar 1.751 MW, me vendndodhje në Bashkinë Bulqizë, Qarku Dibër, te shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k.

Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës së shoqërisë “DRINI BULQIZË” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE, u miratua transferimi i aseteve fikse të HEC “Polemi” nga shoqëria “DRINI BULQIZË” sh.p.k. te shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k., në kuadër të transferimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike dhe në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.

U miratua kërkesa e shoqërisë “NOA ENERGY TRADE” sh.p.k. për ndryshimin e ortakut kryesor që kontrollon interesat e shoqërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Po në këtë mbledhje u vendos shtyrja me 30 ditë të vendimarrjes së për shoqëritë:

“GERTI” sh.p.k. – për plotësimin dhe depozitimin e dokumentacionit të nevojshëm në kuadër të kërkesës për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

“YILDIRIM ENERGY EUROPE ALBANIA” sh.p.k. – për plotësimin dhe depozitimin e dokumentacionit të nevojshëm për rinovimin e licencave në veprimtaritë e furnizimit dhe tregtimit të energjisë elektrike, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Vendimet e plota publikohen në faqen zyrtare të ERE-s dhe në Fletoren Zyrtare.